

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

- I. Seminari i të premtes
- II. Punët kërkimore të sapopërfunduara
- III. Materiale diskutimi në proces
- IV. Artikuj
- V. Aktivitete të tjera

I. SEMINARI I TË PREMTE

Gjatë gjashtëmuorit të parë të vitit 2011, në Serinë e Seminareve të së Premtes janë prezantuar një sërë punimesh nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, nga akademikë të huaj dhe të brendshëm, si edhe nga ekspertë të institucioneve të tjera. Çështjet e trajtuara kanë qenë të ndryshme, ku përmendim ato të fokusuar në politikën monetare dhe stabilitetin financiar, në aspekte të politikës fiskale dhe të politikave zhvillimore, si dhe në çështje të konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare në nivel turizmi dhe bujqësie. Më poshtë do të gjeni një përshkrim më të detajuar të materialeve të prezantuara.

“MAFIA DHE SHPENZIMET PUBLIKE: EVIDENCA E MULTIPLIKATORIT FISKAL NGA NJË GJYSËM- EKSPERIMENT” - NGA SAVERIO SIMONELLI (UNIVERSITETI FEDERIKU II I NAPOLIT, ITALI).

Ky material analizon multiplikatorin e shpenzimeve publike në prodhim, bazuar në shpenzimet për infrastrukturën në rajone të ndryshme të Italisë, si dhe bazuar në ligjin 1991 që mandatonte ndërprerjen

e punëve publike, si rezultat i infiltrimit të mafias në administratën lokale. Për identifikimin e këtij multiplikatori, autorët kanë përdorur metodën e panelit për provinca të ndryshme. Rezultatet empirike tregojnë se ky multiplikator luhet nga 1.4 në 2, duke patur në konsideratë edhe efektin bashkëkohor dhe me vonesë kohore të impaktit të masave antimafia të qeverisë në prodhim.

“INTEGRIMI RAJONAL DHE EFEKTET NË RITJEN EKONOMIKE: PASOJAT NË IHD DHE TREGTI” - NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Qëllimi kryesor i këtij materiali është matja e efektit të integrimit rajonal në terma të rritjes ekonomike, kanalet kryesore të transmetimit si dhe matja e intensitetit të këtyre lidhjeve. Matja e këtij efekti është realizuar me metodën me panel me efekte fikse, që përfshin 9 vende nga Evropa Juglindore për periudhën 1996-2009. Rezultatet e studimit tregojnë se një rajon i integruar përfiton më shumë në terma të tregtisë, kryesisht me anë të eksporteve, dhe në terma të investimeve të huaja direkte. Një

tjetër konkluzion i këtij materiali është që një rajon i integruar rritet më shumë në vëllim nëse stimulon integrimin tregtar dhe konvergjencën ndërindustriale në nivel ndërkombëtar, krahasuar me një rajon me mungesë të këtyre nismave. Një rajon i tillë tërheq gjithashtu më shumë investime të huaja, por analiza tregon se kusht paraprak për këtë është krahu i punës kompetent dhe i disponueshëm. Rezultatet janë të vlefshme në kontekstin e një rajoni ku mbizotëron industria e kostos dhe jo industria e teknologjisë së lartë.

“ZHVILLIMI I TURIZMIT TË QËNDRUESHËM: NJË PËRQASJE EMPIRIKE PËR SHQIPËRINË” - NGA LORENA SKUFI, FITUESE E ÇMIMIT TË PARË TË GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË, VITI 2010.

Studimi trajton disa çështje mbi kuptimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit, si dhe sfidat e ardhshme për zhvillimin e tij në Shqipëri.

Qëllimi kryesor i këtij materiali është analizimi i turizmit të qëndrueshëm në tre dimensionet e tij, matja e impaktit ekonomik, mjedisor dhe social në të ardhurat që gjenerohen nga turizmi. Për analizën sasiore të zhvillimit të turizmit është përdorur modeli i korrjgimit të gabimit (*vector error correction model*). Kërkimi shtrihet në periudhën 1995-2008 dhe rezultatet tregojnë se të ardhurat nga turizmi janë të lidhura pozitivisht me produktin e brendshëm bruto, me zhvillimin social, si dhe lidhen negativisht me degradimin e mjedisit.

“KONSUMI PËR T’U DUKUR: EFEKTET E NDIKIMEVE SOCIALE MBI

KËRKESËN, ÇMIMIN DHE FITIMET E FIRMËS. KONSUMI PËR T’U DUKUR NË SHQIPËRI” - NGA ARMANDO MEMUSHI, FAKULTETI EKONOMIK, UNIVERSITETI I TIRANËS.

Ky punim synon të kuptojë rolin e sjelljes konsumatore “sociale” në përcaktimin e çmimeve të të mirave për t’u dukur dhe të fitimeve e të pjesëve të tregut të firmave që prodhojnë dhe shesin produkte të tilla. Për këtë qëllim është përdorur një model analitik që përfshin influencat sociale në sjelljen e konsumatorit dhe pastaj shqyrtohen ndikimet e tij mbi çmimet, fitimet dhe pjesët e tregut të firmave. Rezultatet për konsumatorin shqiptar tregojnë që: konsumi i të mirave për t’u dukur përbën një pjesë shumë të vogël të konsumit total. Nga ana tjetër, gjinia dhe arsimimi i kryefamiljarit janë faktorët me ndikimin më të madh në nivelin e konsumit për t’u dukur dhe individët që banojnë në Tiranë konsumojnë mesatarisht më shumë produkte për t’u dukur, krahasuar me qytetet e tjera.

“DEFICITI I LLOGARISË KORRENTE NË SHQIPËRI DHE PASOJAT POLITIKE” - NGA ILIR VIKA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky material ka për qëllim të vlerësojë normën ekuilibër të llogarisë korrente në Shqipëri. Vlerësimi është bazuar në dy përjasje, atë të kontabilitetit të propozuar nga Lane dhe Milesi-Ferretti (2206), si dhe në përjasjen empirike mbi vlerësimet në panel të këtyre të dhënave. Niveli ekuilibër i llogarisë korrente që sugjerojnë metodat e përdorura është i ndryshëm, kështu që madhësia e rregullimit të llogarisë korrente duhet të interpretohet me kujdes. Ky material synon gjithashtu të hedhë

dritë edhe mbi pasojat që mund të ketë në të ardhmen për politikën monetare dhe fiskale, përqesimi i mëtejshëm i llogarisë korrente, tendencë e vënë re kryesisht gjatë viteve të fundit.

“VLERËSIMI I EFEKTIT AFATGJATË TË TURIZMIT NË RITJEN EKONOMIKE TË SHQIPËRISË” - NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky studim synon të masë efektin e sektorit të turizmit në rritjen e përgjithshme ekonomike të vendit tonë, gjatë periudhës 1995-2008. Nëpërmjet analizës së fluksit të vizitorëve të huaj dhe të ardhurave totale reale në ekonomi, është studiuar lidhja afatgjatë e turizmit me rritjen ekonomike. Vlerësimi përfundimtar sugjeron se për çdo 5% rritje të qëndrueshme në të ardhurat nga turizmi, ekonomia rritet me 1%. Nga ana tjetër, çdo prishje e këtij ekuilibri kërkon 3.4 tremujorë që të korrigjohet.

“PËRCAKTUESIT MAKROEKONOMIKË TË REMITANCAVE NË SHQIPËRI” - NGA ESIDA ABAZAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky studim synon të masë empirikisht përcaktuesit makroekonomikë të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri gjatë periudhës 1996-2010. Ky është studimi i parë i llojit të vet për rastin e Shqipërisë. Metodologjia e aplikuar është Mekanizmi i Korrigjimit të Vektorit të Gabimeve, që mundëson studimin e dinamikës afatshkurtër dhe afatgjatë të remitancave. Gjetjet tregojnë se remitancat në afatin e gjatë varen vetëm nga kushtet makroekonomike të vendeve mikpritëse, që përfaqësohen nga norma e papunësisë në këto vende, e peshuar me pjesën e remitancave që vjen nga secili vend mikpritës. Një rritje e normës së

papunësisë me 1 pp, i redukton flukset e remitancave me 0.13% në afatin e gjatë. Ndërsa ndryshoret e tjera shpjeguese (kursi i këmbimit dhe PBB-ja e Shqipërisë) rezultuan statistikisht të parëndësishme, si në afatin e shkurtër ashtu dhe në afatin e gjatë, duke hedhur poshtë hipotezën që remitancat dërgohen kryesisht për të plotësuar nevojat e konsumit të familjeve të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës. E vetmja gjetje që mbështet motivin altruist të remitancave është koeficienti i lartë dhe statistikisht i rëndësishëm i termit të korrigjimit të gabimit. Nga ana tjetër, studimi nuk gjeti evidencë në mbështetje të motivit të investimit të remitancave.

“QEVERISJA E BANKAVE NË SHQIPËRI”, NGA KLITI CECA, IRINI KALLUCI, ORIELA KODRA, (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE) VASILIKA KOTA, (DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR) DHE ARZANA HAXHIAJ, (DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE).

Qëllimi kryesor i këtij materiali ishte evidentimi i rolit dhe rëndësisë që ka mirëqeverisja e bankave në Shqipëri, matja e të cilës u realizua me anë të llogaritjes së indeksit të qeverisjes së bankave për sistemin bankar shqiptar.

“CIKLET POLITIKE NË TË ARDHURAT NGA PRIVATIZIMI: RASTI I SHQIPËRISË”, NGA DRINI IMAMI, ENDRIT LAME (UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS) DHE HOLGER KÄCHELEIN (FAKULTETI EKONOMIK, TIRANË).

Ky material ka për qëllim evidentimin e cikleve politike në Shqipëri, kryesisht gjatë proceseve zgjedhore, duke përdorur instrumente të ndryshme ekonomike, si për

shembull instrumente të politikës fiskale dhe monetare. Në studimin e mëparshëm për ekzistencën e cikleve politike në Shqipëri është gjetur një evidencë e qartë e ekspansionit fiskal përpara zgjedhjeve. Në këtë material si element i financimit të qeverisë dhe i rritjes së ekspansionit fiskal në vendet në tranzicion janë marrë të ardhurat nga privatizimi, për të testuar nëse kemi një rritje të tyre, para zgjedhjeve elektorale. Rezultatet empirike tregojnë një rritje të konsiderueshme dhe statistikisht të rëndësishme të të ardhurave nga privatizimi para zgjedhjeve, duke kontribuar si element bazë i financimit të rritjes së shpenzimeve të qeverisë në këto periudha.

“NIVELI OPTIMAL I REZERVËS VALUTORE: NJË VLERËSIM EMPIRIK PËR RASTIN E SHQIPËRISË” - NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky material studimi analizon lidhjen ndërmjet ndryshueshmërisë në transaksionet ndërkombëtare, kostos financiare dhe nivelit të rezervës në rastin e Shqipërisë. Qëllimi i parë është të shqyrtohet ndikimi i ndryshimeve në transaksionet ndërkombëtare në rezervën e mbajtur dhe së dyti të vlerësohet rezerva optimale nga pikëpamja e kostos oportune të mbajtjes së saj. Materiali mbështetet mbi modelin Buffer-Stock, i cili supozon se rezerva optimale ndikohet nga luhatshmëritë në shpenzimet dhe të ardhurat në bilancin e pagesave. Rezerva shërben si amortizues për të zbutur luhatjet në transaksionet e jashtme, ndërsa stoku fillestar është niveli optimal i rezervës. Fokusi i modelit është vlerësimi i rezervës optimale me qëllim sigurimin e mundshëm kundrejt goditjeve nga

faktorë ekzogjenë ose “kriza”, veçanërisht nga ndërprerjet e flukseve të kapitaleve të huaja dhe kryesisht të remitancave. Volatiliteti i ndryshimit të rezervës është kapur nëpërmjet përfaqesjes Autoregressive Conditional Heteroskedasticity (ARCH), ndërsa modeli Buffer-Stock është vlerësuar me metodën ARDL. Rezultatet paraqesin një lidhje negative të rezervës me volatilitetin e ndryshimeve në transaksionet ndërkombëtare, negative me kostot oportune, dhe pozitive ndaj vëllimit të importeve. Rezultatet sugjerojnë se rezerva optimale është më tepër e ndjeshme ndaj ndryshimeve në bilancin e llogarisë korrente se sa ndaj kostos oportune të mbajtjes së saj.

“MBAS KRIZËS, STRATEGJITË E REJA PËR POLITIKËN MONETARE EVROPIANE DHE MENAXHIMI I SAJ” - NGA PROF. FRANCO BRUNI, UNIVERSITETI BOCCONI, MILANO.

Çështjet kryesore që u trajtuan nga Profesor Bruni lidheshin me strategjitë e reja dhe sfidat me të cilat duhet të përballet BE (Bashkimi Evropian) në të ardhmen, në kuadër të paktit të rritjes, stabilitetit dhe qeverisjes së anëtarëve të saj. Kriza financiare që preku globin në vitin 2007, solli një këndvështrim të ri për politikën monetare kudo në botë. Fokusi i saj në të ardhmen nuk do të jetë vetëm qëndrueshmëria e çmimeve, por edhe stabiliteti financiar, si një objektivi eksplicit i politikës monetare në të ardhmen.

“A MUND TË KONKURROJË EKONOMIA BUJQËSORE E VOGËL SHQIPTARE NË KUSHTET E KONKURENCËS SË TREGUT AGROUSHQIMOR RAJONAL E EVROPIAN” - NGA ISMAIL BEKA, ZËVENDËSDREJTOR I GIZ (DEUTSCHE

GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT).

Ky prezantim kishte për qëllim analizimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri, problemet që ka aktualisht ky sektor, si dhe evidentimin e sfidave të ardhshme. Të dhënat zyrtare të INSTAT-it tregojnë se gjysma e popullsisë shqiptare jeton në zonat rurale dhe se bujqësia është një ndër veprimtaritë jetike të tyre. Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit,

reformat në këtë sektor kanë qenë të pakta, duke bërë që ekonomia shqiptare të vazhdojë të jetë një vend importues neto, pavarësisht burimeve potenciale natyrore që ka. Kështu, ndër sfidat e ardhshme për rigjallërimin e mëtejshëm të sektorit bujqësor përmendim: urbanizimin e zonave të caktuara, planifikimin rural dhe hapësinor, edukimin dhe kualifikimin e individëve, përcaktimin e strategjive të reja me vizione afatgjata etj.

II. PUNËT KËRKIMORE TË SAPOPËRFUNDUARA

“ROLI I KUFIZIMEVE BUXHETORE NË TEORINË E PRITSHMËRIVE RACIONALE. NJË KUADËR PËR MODELIMIN DHE DISKUTIMIN E STABILITETIT FINANCIAR” - NGA ARDIAN FULLANI (GUVERNATOR I BANKËS SË SHQIPËRISË) DHE ALTIN TANKU (DREJTOR I DEPARTAMENTIT TË KËRKIMEVE).

Ky material ka për qëllim pasurimin e modelimit ekonomik me anë të dy objektivave specifikë. Së pari, studimi rishikon argumentin e pritshmërive racionale me qëllim propozimin e një metode të re që sjell modelet më afër realitetit. Së dyti, ofron një përkufizim dhe një kornizë të re për analizimin e çështjeve të stabilitetit financiar në kuadër të politikës monetare. Studimi vëren se literatura ekzistuese nuk e ka marrë plotësisht në konsideratë zgjidhjen e propozuar nga Blanchard dhe Kahn (B&K) të modeleve me pritshmëri racionale. Më konkretisht, studimi propozon të zëvendësojë identitetet e burimeve ekzistuese në model me lidhjet kointegruese, si një mënyrë për të prezantuar më shumë fleksibilitet

pa ndikuar prioritetet apo numrin total të kufizimeve, të cilat janë të nevojshme për të zgjidhur modelin në mënyrën e pritshmërive racionale. Kjo është bërë duke përforcuar modelet DSGE (*Diagnostics Stochastic General Equilibrium Model*), me fuqinë e modeleve VECM-së (*Vector Error Correction Mechanism*). Supozimi kryesor këtu është se agjentët janë racionalë, çka është e vërtetë vetëm në afatin e gjatë, sepse ata përjetojnë jo-racionalitete të qëllimshme apo aksidentale dhe/ose ka humbje informacioni në afatin e shkurtër. Përveçse sjell fleksibilitet, ky propozim ofron një përjasje më realiste dhe më logjike për modelin hibrid apo goditjet strukturore të propozuara nga vetë autorët.

“QEVERISJA E KORPORATAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR - ANALIZË E ANKETIMIT TË KRYER PËR QEVERISJEN E KORPORATAVE NË SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR” - NGA KLITI CECA, IRINI KALLUCI, ORIELA KODRA (DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE), VASILIKA KOTA

1 Material konfidencial.

(DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR) DHE ARZANA HAXHIAJ (DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE).

Në kuadër të rëndësisë së zhvillimit të sektorit bankar në Shqipëri, materiali synon të vlerësojë cilësinë e qeverisjes së bankave në vend. Ky studim merr rëndësi të veçantë pasi mirëqeverisja e bankave ndikon në krijimin dhe ruajtjen e një sistemi bankar, si të qëndrueshëm ashtu edhe fitimprurës. Për herë të parë është matur në formën e një Indeksi të Qeverisjes Bankare, cilësia e qeverisjes së sistemit bankar shqiptar bazuar në informacionin e grumbulluar nga bankat nëpërmjet pyetësorëve të plotësuar. Si bazë krahasuese janë përdorur praktikat e mirëqeverisjes të përcaktuara nga Bank for International Settlements (BIS) për të vlerësuar jo vetëm se si në tërësi bankat

në Shqipëri aplikojnë këto praktika, por edhe për të krahasuar bankat me njëra-tjetrën. Parimet e BIS u rigrupuan sipas gjashtë seksioneve kryesore:

1. Kuadri institucional dhe sistemi i qeverisjes në banka;
2. Procesi i auditimit;
3. Roli i Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë;
4. Menaxhimi i burimeve njerëzore në banka;
5. Specifikimi i detyrave dhe roli i drejtuesve;
6. Niveli i pagave.

Përveç matjes së një indeksi të përgjithshëm për gjithë aspektet e qeverisjes bankare, u matën edhe 6 nënindekse, nga një për secilin prej seksioneve të mësipërme.

III. MATERIALE DISKUTIMI NË PROCES

“VLERËSIMI EMPIRIK I MODELIT TË GRAVITETIT: RASTI I SHQIPËRISË” - NGA ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë rolin specifik që luajnë faktorët si: afërsia fizike, gjuha e përbashkët, historia dhe zona e tregtisë të lirë në shkëmbimet tregtare. Ky studim aplikon koeficientë të rinj të vlerësuar për modelin e gravitetit, për tregtinë midis Shqipërisë dhe partnerëve kryesorë të saj. Janë evidentur disa nga variablat kryesorë që ndikojnë në flukset tregtare si dhe janë përcaktuar elementët specifikë në lidhje me secilën nga vendet e veçanta. Një nga rezultatet e marra është që nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe

për tregtinë e lirë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor ka ndikuar pozitivisht shkëmbimet tregtare. Ndërkohë që variabli i afërsisë fizike midis shteteve nuk ka rezultuar me ndikimin e sugjeruar nga literatura përkatëse.

STUDIMI I SJELLJES SË KREDITIMIT: A KEMI ARRITUR POTENCIALIN E MUNDSHËM NË SHQIPËRI?” - NGA IRINI KALLUCI, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Qëllimi i këtij materiali është studimi i sjelljes së kreditimit në Shqipëri, arsyet e rritjes së shpejtë të kredisë sidomos në vitet 2004-2008, por edhe ndryshimin e tendencave në vitet që pasuan krizën

financiare globale. Për vendet në zhvillim, ky vlerësim është disi i vështirë, pasi rritja e kreditimit dhe shmangia nga ekuilibri afatgjatë mund të jetë pjesë e procesit konvergjuës. Për më tepër, sjellja e kreditimit ka ndryshuar që pas fillimit të krizës financiare globale dhe ngadalësimi në rritjen e tij mund të jetë shkaktuar, si nga ngadalësimi ekonomik (pasoje e krizës), por edhe nga arritja e potencialit të mundshëm (pikës ekuilibër të kreditimit). Pikërisht këtyre hipotezave synon t'u japë përgjigje studimi. Nëpërmjet identifikimit të një *benchmark*-u natyral që ofrojnë vendet e zhvilluara të Eurozonës apo ato në zhvillim (të rajonit), do të bëhen përpjekje për të matur nivelin ekuilibër afatgjatë të kreditimit për Shqipërinë.

“NDJESHMËRIA E TREGUT VALUTOR NDAJ LAJMEVE EKONOMIKE” - NGA ILIR VIKA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky studim përpiket të shpjegojë volatilitetin e kursit të këmbimit në afatin e shkurtër. Kjo testohet duke vlerësuar nëse tregu valutor reagon menjëherë ndaj lajmeve ekonomike dhe nëse ndryshimet

e sjella ndihen edhe në ditët në vazhdim. Krahas vlerësimit të reagimit të kursit ndaj lajmeve ekonomike, synim tjetër është matja nëse këto të fundit ushtrojnë impakt mbi kursin e këmbimit edhe nëpërmjet vëllimit të blerje-shitjeve në tregun valutor.

“NDËRMJETËSIMI FINANCIAR DHE RENDIMENTI MAKROEKONOMIK I EKONOMISË SHQIPTARE NË FORMIMIN DHE SHPËRNDARJEN E KAPITALIT” - NGA JONEL KRISTO, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Në një ekonomi joefikase ka kursime të tepërta që çojnë në grumbullim të tepërt të kapitalit dhe për rrjedhim, alokim joeficient të burimeve. Ashtu siç edhe e kundërta është e vërtetë. Pasojat janë të shumta, por mes të tjerash spikat mosrealizimi i potencialeve investuese ose shpërdorimi i kapitalit. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë nëse ekziston ose jo ekuilibri mes nivelit të kursimeve dhe formimit të kapitalit (ose alokimit eficient të burimeve), duke u bazuar në nivelin e ndërmjetësimit financiar që shfaq sistemi bankar shqiptar.

IV. ARTIKUJ

Artikujt e përgatitur nga Departamenti i Kërkimeve gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011 janë si më poshtë:

“TREGTIA AKTUALE DHE AJO POTENCIALE NDËRMJET SHQIPËRISË DHE PARTNERËVE TË SAJ KRYESORË” - NGA ALBAN PLLAHA, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky artikull ofron një përshkrim

metodologjik të modelit të gravitetit për tregtinë. Në artikull gjithashtu përshkruhen të dhënat e aplikuara nga modeli, si dhe prezantohet një përmbledhje e gjetjeve më të rëndësishme. Kështu, projeksionet e modelit sugjerojnë se niveli i shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit të Evropës Juglindore janë shumë larg potencialeve të tyre. Projeksionet sugjerojnë se në kushtet aktuale ekonomike, shkëmbimet tregtare

ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera të rajonit mund të intensifikohen me më shumë se 80%, krahasuar me ato aktuale. Rezultatet e përfuara nga materiali sugjerojnë se shkëmbimet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe partnerëve të saj kryesorë në BE (Itali dhe Greqi), janë pranë niveleve të tyre optimale. Ndërkohë ekziston mundësia e intensifikimit të shkëmbimeve tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë me rreth 90% më shumë nga ato aktuale.

“PËRCAKTUESIT MAKROEKONOMIKË TË REMITANCAVE NË SHQIPËRI” - NGA ESIDA ABAZAJ, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky studim synon të masë empirikisht përcaktuesit makroekonomikë të dërgesave të emigrantëve në Shqipëri, gjatë periudhës 1996-2010. Ky është studimi i parë i llojit të vet për rastin e Shqipërisë. Metodologjia e aplikuar është Mekanizmi i Korrigjimit të Vektorit të Gabimeve, që mundëson studimin e dinamikës afatshkurtër dhe afatgjatë të remitancave. Gjetjet tregojnë që remitancat në afatin e gjatë varen vetëm nga kushtet makroekonomike të vendeve mikpritëse, që përfaqësohen nga norma e papunësisë në këto vende, e peshuar me pjesën e remitancave që vjen nga secili vend mikpritës. Një rritje e normës së papunësisë me 1pp, i redukton flukset e remitancave me 0.13% në afatin e gjatë. Ndërsa ndryshoret e tjera shpjeguese (kursi i këmbimit dhe PBB-ja e Shqipërisë) rezultuan statistikisht të parëndësishme, si në afatin e shkurtër ashtu dhe në afatin e gjatë, duke hedhur poshtë hipotezën që remitancat dërgohen kryesisht për të plotësuar nevojat e konsumit të familjeve të emigrantëve shqiptarë në vendin origjinë.

E vetmja gjetje që mbështet motivin altruist të remitancave është koeficienti i lartë dhe statistikisht i rëndësishëm i termit të korrigjimit të gabimit. Gjithashtu, studimi nuk gjeti evidencë në mbështetje të dërgesave për motive investimi.

“VLERËSIMI I LUHATSHMËRISË SË REZERVËS VALUTORE DHE SHMANGIA NGA NIVELI OPTIMAL: RASTI I SHQIPËRISË” - NGA GERTI SHIJAKU, DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE.

Ky artikull ka për qëllim analizimin e luhatshmërisë së rezervës valutore në Shqipëri, bazuar në evidencat empirike të materialit studimor me temë: “Niveli optimal i rezervës valutore: Një vlerësim empirik për rastin e Shqipërisë”². Vlerësimet empirike evidentuan që niveli aktual i rezervave të mbajtura është më i lartë krahasuar me nivelin optimal të vlerësuar. Analiza e kontributit të peshuar të secilit prej treguesve makroekonomikë sugjeron se diferenca në rritje midis nivelit aktual dhe atij optimal është shkaktuar kryesisht nga rënia e kostos oportune e mbajtjes së rezervave valutore dhe rritja e luhatshmërisë së nivelit të akumuluar të rezervave si pasojë e krizës financiare dhe ekonomike. Gjithashtu, rezultatet tregojnë se kriza ekonomike financiare ka pasur një ndikim më të dukshëm në dinamikën e rezervës valutore.

² Shijaku, G., 2011 publikuar në librin “Politikat ekonomike në EJT: Hartimi, ecuria dhe sfidat”, Fullani, A., 2011.

V. AKTIVITETE TË TJERA

KURS2-JAVORI FMN-SË NË QENDRËN E KËRKIMIT DHE TRAJNIMIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Institutin e FMN-së (Fondi Monetar Ndërkombëtar) organizoi në Qendrën e Trajnimit dhe Kërkimit të Beratit, në datat 6-17 qershor 2011, kursin dyjavor me temë "Menaxhimi makroekonomik dhe Çështjet e stabilitetit financiar në Evropën Juglindore". Objektiv i këtij aktiviteti të rëndësishëm ishte pajisja e pjesëmarrësve me një të kuptuar praktik të temave që lidhen me politikën makroekonomike. Për këtë qëllim, programi theksonte kuadrin analitik që përdoret për të vlerësuar qëndrueshmërinë e borxhit dhe konkurrueshmërinë në tregjet e jashtme; rëndësinë e lidhjeve makrofinanciare e çështjeve të sektorit financiar, si dhe rolin e reformave strukturore në drejtim të nxitjes së rritjes dhe zhvillimit ekonomik. Programi i aktivitetit parashikonte edhe një panel përmbyllës të nivelit të lartë mbi zhvillimet ekonomike të fundit dhe ato të pritshme në Evropën Juglindore. Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 25 zyrtarë të nivelit të mesëm të bankave qendrore apo ministrive të financave të rajonit, të cilët në një të ardhme të afërt mendohet të jenë përgjegjës për formulimin e politikave makroekonomike e financiare.

SEMINARI I NIVELIT TË LARTË MIDIS UNIVERSITETIT TË OKSFORDIT DHE BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Universitetin e Oksfordit organizoi më datë 21 qershor 2011, seminarin e nivelit të lartë "Sfidat ekonomike aktuale dhe bashkëpunimi rajonal në Evropën

Juglindore". Qëllimi i këtij seminari ishte evidentimi i sfidave ekonomike me të cilat përballen vendet e Evropës Juglindore si dhe identifikimi i hapësirave të mundshme për forcimin e bashkëpunimit rajonal. Temat rreth të cilave u fokusua ky seminar ishin:

1. identifikimi i një axhende të rritjes së qëndrueshme për rajonin tonë,
2. ndikimi pozitiv i ankorave të jashtme në nxitjen e bashkëpunimit ekonomik rajonal,
3. fushat e bashkëpunimit ekonomik rajonal të ardhshëm.

Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues nga rrethet akademike në Shqipëri, në rajon e më gjerë, përfaqësues nga sistemi bankar, institucione shtetërore, organizma ndërkombëtarë në Shqipëri dhe përfaqësues nga Banka e Shqipërisë. Seminari i organizuar është pjesë e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bankës së Shqipërisë dhe Universitetit të Oksfordit e nënshkruar në shtator 2010. Ky aktivitet theksoi edhe njëherë rolin e Bankës së Shqipërisë për të qenë një aktor aktiv në iniciativat e bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore.

SEMINARI TEKNIK

Departamenti i Kërkimeve, në kuadër të Strategjisë Afatmesme të Zhvillimit të Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, organizon një herë në dy muaj, Seminarin Teknik. Ky seminar ka si objekt prezantimin e të rejave më të fundit shkencore në fushën e ekonomisë, metodave të reja të zgjidhjes së problemeve të ndryshme, zhvillimin e modeleve origjinale matematikore

të proceseve dhe fenomeneve, si dhe rezultatet e marra nga përdorimi i tyre etj. Gjatë periudhës janar-qershor të vitit 2011, janë organizuar tre prezantime që kanë trajtuar këto tema:

- i) “Aplikimi i Teknikave Ekonometrike Bajeziane”, nga Armela Mançellari, Departamenti i Kërkimeve

Ky seminar kishte për qëllim aplikimin e teknikave ekonometrike Bajeziane, i konceptuar në tre seri prezantimesh. Pjesa e parë e prezantimit e realizuar gjatë muajit prill, u fokusua në demonstrimin e teknikave bajeziane në ekuacione të thjeshta lineare ose autoregresive gjatë procesit të modelimit dhe parashikimit. Në prezantim u diskutua metoda klasike e vlerësimit ekonometrik, Metoda e Katrorëve më të Vegjël, e kombinuar me konceptin e *priors* dhe *posterior* të vlerësimit bajezian, i cili në këtë rast u realizua nga aplikimi i algoritmit Gibbs Sampling. E veçanta e teknikës bajeziane është se të lejon të përfshish gjykimin e ekspertëve mbi parametrat e vlerësuar në vlerësimet ekonometrike, të cilat mund të jenë teorike ose praktike, të fituara nga eksperiencia, mbi marrëdhëniet ekonomike. Avantazhet kryesore që të ofron aplikimi i teknikave bajeziane në modelim është saktësia e përfundimeve në kampione të vogla, si dhe përfshirja e informacionit cilësor, krahas atij sasior.

- ii) “Qeverisja e korporatave: parimet e mirëqeverisjes së bankave”, nga Oriela Kodra, Departamenti i Kërkimeve

Qëllimi kryesor i këtij seminari teknik kishte të bënte me njohjen e konceptit të “qeverisjes së korporatave”, rëndësinë e

tij, pse lindi dhe parimet kryesore në të cilat u mbështet. Kështu me qeverisje të korporatave, të përcaktuar në mënyrë të detajuar nga OECD, kuptojmë “tërësinë e marrëdhënieve midis menaxhimit të kompanisë, Këshillit Drejtues të saj, aksionerëve dhe palëve të interesuara”. Në këtë kuadër, qeverisja e korporatave ka të bëjë me të gjitha procedurat që ndiqen për drejtimin e kompanive, mënyrën e vendosjes së objektivave, mjetet për t’i arritur ato dhe mënyrat e vlerësimit të performancës. Mirëqeverisja e korporatave (bankave), siguron në këtë mënyrë përdorimin me efektivitet të burimeve të kompanisë. Duke qenë se bankat janë pjesa përfaqësuese e sistemit financiar, mirëqeverisja e tyre merr rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të vendit në tërësi.

- iii) “Tregu i punës dhe papunësia në Shqipëri”, nga Jonel Kristo, Departamenti i Kërkimeve

Ky prezantim kishte për qëllim analizimin e të dhënave të tregut të punës dhe papunësisë në Shqipëri dhe në rajonet e tjera të botës. Një fokus i veçantë ishte përkufizimi i treguesve të ndryshëm, përkufizimi i matjeve aktuale, si dhe një vështrim mbi metodologjinë matëse të nivelit të papunësisë, dhe krahasimit të këtyre të fundit me BE dhe SHBA. Gjithashtu u trajtuan karakteristikat kryesore të serisë së papunësisë, në terma të thyerjeve strukturore që ka pësuar ajo, si dhe të ecurisë së saj në vite. Në këtë seminar u paraqitën edhe vlerësime alternative të papunësisë, si NAIRU (*Non-Acceleratin Inflation Rate Of Unemployment*), NAWRU (*Non-Accelerating Wage Rate Of Unemployment*) si dhe lidhjet që mund të ketë ecuria e papunësisë me normën e inflacionit dhe aplikimi i tyre në të ardhmen.

LINQE:**PUNË KËRKIMORE TË BANKAVE TË TJERA QENDRORE**

Banca d'Italia (<http://www.bancaditalia.it/studiricerche>)

Banco de Espana (<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>)

Bank of England (<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>)

Bank of Finland (http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm)

Bank of Greece (<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>)

Czech National Bank (<http://www.cnb.cz/en/research/>)

Deutsche Bundesbank (http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php)

European Central Bank (<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>)

Oesterreichische Nationalbank (http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp)

Federal Reserve (<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>)

TË TJERA

BIS Central Bank Research Hub (<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>)

International Journal of Central Banking (<http://www.ijcb.org/>)

National Bureau of Economic Research (<http://www.nber.org/>)

International Monetary Fund (<http://www.imf.org/external/pubind.htm>)

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.

Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Avni Rustemi", Nr.24, Tiranë

Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3

Faks: + 355 4 2419408

E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 700 kopje

Shtypur në shtypshkronjën *AdelPrint*